



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 118 Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 30 8 / 2023

**VENDIM**

Nr.27, date 30/08/2023

**PËR**

**AKTIN E KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT PËR REHABILITIMIN E MEKANIZMIT TË PORTAVE TË UJËLËSHUESIT DHE SHKARKUESIT ANËSOR TË DIGËS PEZË GJYSLIKONE QË SHFRYTËZOHET NGA BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", Neni 3,4,6,9,10, dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Neni 24, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 26.07.2023 mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga Bashkia Tirane në lidhje me procesin e kolaudimit të punimeve të zbatimit për projektin e rehabilitimit të mekanizmit të portave të Ujeleshuesit dhe shkarkuesit anesor të digës Peze Gjyslikone. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur u vërejt se ky dokumentacion nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 24 të VKM Nr. 147. Projekti sipas faktit i paraqitur jo vetëm që nuk pasqyron punimet reale të kryera por ka edhe ndryshime nga projekti origjinal të cilat nuk janë miratuar nga KKDM sipas nenit 17 të VKM perkatëse. Në këtë dokumentacion mungon relacioni në lidhje me kontrollin dhe provat e materialeve të ndertimit të vendosura në objekt të percaktuara në nenin 22 dhe 23 të VKM se mesipërme dhe të kerkuara në Vendimin e KKDM Nr 35, dt.12.10.2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se shfrytëzuesi i digës nuk ka plotësuar asnjë prej kërkesave të pikës 2 të Vendimit të KKDM Nr. 35, date 12.10.2021, për miratimin e projektit në fjalë. Disa prej këtyre kërkesave duhet të plotësoheshin dhe të paraqiteshin në KKDM përpara fillimit të punimeve. Gjithashtu, në dokumentacionin e paraqitur nuk jepen një Raport i plote i mbikqyresit të punimeve në përfundim të këtyre punimeve dhe licenca e mbikqyresit të punimeve. Nga dokumentacioni i kolaudimit të paraqitur rezultojnë se janë kryer ndryshime në projekt në një kohë që sipas legjislationit në fuqi, çdo ndryshim në projekt duhet të miratohet nga KKDM.

Gjate mbledhjes u diskutua në lidhje me problematikat e konstatuara gjate procesit të mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të rehabilitimit sic janë mosplotësimi i kërkesave të nenit 20, 22, 23, 24 të VKM Nr. 147 së mësipërme, etj. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Të mos miratohet aktin e kolaudimit të punimeve të zbatimit për Rehabilitimin e mekanizmit të Portave të Ujeleshuesit dhe Shkarkuesit Anesor të digës së Peze Gjyslikone** të paraqitur nga Bashkia Tirane për arsye të mosplotësimit të kërkesave të legjislationit në fuqi, ndryshimeve të projektit origjinal pa miratimin e KKDM dhe për mosplotësimin e kërkesave të Vendimit të KKDM Nr. 35, date 12/10/2021.
- 2- Ti kërkohet Bashkisë Tirane** si shfrytëzuese e digës së Peze Gjyslikone dhe përgjegjëse për zbatimin e punimeve të rehabilitimit:
  - Të plotësojë dokumentacionin e plote për procesin e Kolaudimit të punimeve të zbatimit për rehabilitimin e mekanizmit të portave të Ujeleshuesit dhe shkarkuesit anesor të digës së Peze Gjyslikone sipas kërkesave të nenit 24 të VKM Nr. 147, dt. 18.03.2004 si dhe kërkesave të shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 35, date 12/10/2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Te njoftoj KKDM sipas VKM se mesiperme ne lidhje me procesit te kolaudimit te punimeve te zbatimit sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi
- Te kryeje verifikimet e duhura ne lidhje me sasine dhe cilesine e punimeve te kryera ne objekt, te jape informacion ne lidhje me te dhenat gjeoteknike te materialeve te ndertimit te perdorura gjate punimeve duke perfshire edhe te dhenat perkatese te karriera, te kryeje llogaritjet e qendrushmerise se diges pas rehabilitimit te saj si dhe llogaritjet e vales vershuese ne rast te prurjeve maksimale qe mund te vijne nje here ne 100 vjet dhe nje here ne 1000 vjet apo te prishjes se mundshme te diges, te jape informacion ne lidhje me perputhshmerine e punimeve te kryera sipas faktit me projektin original te miratuar nga KKDM.
- Te pregatitet nje Raport ne lidhje me gjetjet dhe rezultatet e kerkuara ne piken e mesiperme si dhe per plotesimin e kerkesave te KKDM te dhena ne piken 2 te Vendimin perkates per miratimin e projektit ne fjale. Raporti duhet te shoqerohet me llogaritjet perkatese, me vizatimet sipas faktit te punimeve te kryera, me te dhenat e rezultateve te provave te materialeve te ndertimit te kerkuara ne nenin 22 dhe 23 te VKM se mesiperme.
- Te paraqese Aktin e ri te kolaudimit te kryer sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe kerkesave te mesiperme per miratim ne KKDM. Akti i kolaudimit duhet te kryhet nga nje grup kolaudimi me licence ne fushen e mbikqyrjes dhe kolaudimit te punimeve ne digat e medha. Ne perberje te grupit duhet te marrin pjese edhe ekonomist dhe Jurist si dhe perfaqesues te KKDM sipas kerkesave te nenit 24 te VKM Nr. 147.

3- **Ti kerkoj Bashkise Tirane si shfrytezuese e diges se Peze Gjyslikone:**

- Hartimin dhe Dorezimin brenda muajit Nendor 2023 te **Rregullores se shfrytezimit, mirembajtjes, monitorimit dhe Sigurise se diges se Peze Gjyslikone** sipas legjislacionit ne fuqi
- Hartimin dhe dorezimin para sezonit te rreshjeve te **Planit te Gadishmerise se emergjencave civile** per shkak te prishjes se mundshme te diges apo plotave maksimale te rreshjeve 1 here ne 100 vjet dhe nje here ne 1000 vjet. Ky Plan duhet te shoqerohet me kurbat e volumeve dhe siperfaqeve faktike aktuale te ujit te matura ne rezervuar si dhe me skenaret perkates te alarmit si dhe hartat e permbytjeve ne zonen urbane poshte diges te shoquara me numrin e njerezve ne rrezik per keto raste.

4- **Te informoj Institucionet perkatese dhe Keshillin e Ministrave per situaten dhe prolematikat e konstatuara ne digen e Peze Gjyslikone:**

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM per ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**PËR KOMITETIN KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

